



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

TEKSTIL-KONFEKSIONE

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

D-IV-25

Tiranë 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Ofruesit.....	4
Data e validimi.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	6
NjN-04-IV-0237-25 Krijimi i koleksionit (të veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve)	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-04-IV-0238-25 Analizimi, planifikimi dhe organizimi i punës në tekstil konfeksion	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-04-IV-0239-25 Mbikëqyrje në tekstil konfeksion dhe lëkurë këpucë	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-04-IV-0240-25 Kontrolli i cilësisë së produktit përfundimtar në tekstil - konfeksion .	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13

NjN-04-IV-0241-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit në tekstil – konfeksion.....	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse.....	15
Modalitetet e vlerësimit	16
Informacion shtesë	16
SHËNIM	16

Emërtimi i kualifikimit	TEKSTIL-KONFEKSIONE			Kodi
Kohëzgjatja	1100-1500 orë nacionale	Niveli	Niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK	D-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione” niveli IV në KSHK , referuar niveli IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit “Teknik/menaxher” i mesëm në fushën e Tekstil-konfeksioneve dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të sektorëve të prodhimit në tekstil-konfeksion të kësaj fushe apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat, person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Tekstil-konfeksione” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: - kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të nivelit III (KSHK), referuar niveli III të KEK në kualifikimin profesional “Tekstil-konfeksione”; - Janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; - pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli, si teknik/menaxher i mesëm në këtë fushë, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme që ushtrojnë aktivitetet në kualifikimin profesional “Tekstil – konfeksione” (kompani të prodhimit të tekstileve, veshjeve, çantave, këpucëve, aksesoreve, artikujve të tjerë etj.). Gjithashtu, individë mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi në fushën e tekstil-konfeksioneve dhe përpunimit të lëkurës. Me përfundimin e këtij niveli, individë ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	D-III-15; D-IV-19			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional **“Tekstil-konfeksione”**, **niveli IV në KSHK**, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve dhe punonjësve në njësinë e tij prodhuese;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të ndërmarrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, të jetë i matur dhe i sjellshëm me eprorët, vartësit, partnerët, etj.;
9. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
10. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
11. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
12. Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partnerët, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese;
13. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
14. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
15. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;

16. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
17. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
18. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
19. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
20. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
21. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehi profesionale).

NjN-04-IV-0237-25 Krijimi i koleksionit (të veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve)

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë zhvillimin e modës në periudha të ndryshme historike dhe ndikimin e saj në tendencat/stilet/mënyrat e veshjes;
2. Të përshkruajë burimet e frymëzimit;
3. Të shpjegojë tendencat e modës;
4. Të shpjegojë çfarë është koleksioni në modë;
5. Të përshkruajë fazat kryesore të një koleksioni mode;
6. Të shpjegojë konceptet mbi dizejnimin e koleksionit;
7. Të përshkruajë procedurat e realizimit të modeleve të koleksionit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të bashkëpunojë për të garantuar zbatimin e hapave për realizimin e një koleksioni;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e realizimit të modeleve të një koleksioni.

Kriteret e vlerësimit

- Përshtat periudhat e ndryshme të modës me krijime bashkëkohore;
- Bashkëpunon për të garantuar zbatimin e hapave për realizimin e një koleksioni duke respektuar përmasat, linjat trupore dhe detajet teknike;
- Mbikëqyr zbrërthimin në mënyrë të saktë të elementëve të një koleksioni mode;
- Mbikëqyr realizimin e modeleve të koleksionit sipas skicës.

NjN-04-IV-0238-25 Analizimi, planifikimi dhe organizimi i punës në tekstil konfeksion

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të një ndërmarrje;
2. Të shpjegojë mënyrën e strukturës organizative të një ndërmarrje;
3. Të analizojë rëndësinë e planifikimit të proceseve të punës;
4. Të analizojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore;
5. Të analizojë rëndësinë dhe mënyrat e menaxhimit të mjeteve, materialeve/lëndëve të para dhe pajisjeve të punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e radhës së punës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
8. Të analizojë rëndësinë e mbikëqyrjes së sistemimit dhe pastrimit të vendit të punës;
9. Të analizojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip;
10. Të analizojë mënyrat dhe rëndësinë e mbikëqyrjes së kohës së realizimit të proceseve;
11. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
12. Të argumentojë rëndësinë e dokumentimit të punës së kryer;
13. Të analizojë rëndësinë e arkivimit/menaxhimit të shablloneve;
14. Të argumentojë rëndësinë e raportimit të punës së kryer.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë prurjet e porosive dhe të organizimit të punës;
2. Të kryejë menaxhimin e burimeve materiale të nevojshme;
3. Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore;
4. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin e punës.

Kriteret e vlerësimit

- Merr porosinë sipas kërkesave;
- Analizon porosinë sipas prioriteteve;
- Mbikëqyr zbatimin e radhës së punës sipas proceseve;
- Mbikëqyr zbatimin e kohës së punës të proceseve, sipas skedës teknike;
- Planifikon mjetet, materialet dhe pajisjet e punës në varësi të specifikave dhe proceseve të punës;
- Menaxhon burimet materiale sipas kërkesë/ofertës në mënyrë efikase;
- Planifikon burimet njerëzore sipas kërkesave dhe profileve teknike;
- Menaxhon burimet njerëzore duke ndarë detyrat, sipas kualifikimit dhe proceseve të punës;
- Mbikëqyr funksionalitetin dhe gatishmërinë e mjeteve/pajisjeve të punës, sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, sipas kushteve teknike;

- Bashkëpunon me kolegë/specialistë të tjerë, sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr dokumentimin e punës së kryer sipas standardeve dhe formateve;
- Raporton rregullisht tek eprori sipas formateve përkatëse.

NjN-04-IV-0239-25 Mbikëqyrje në tekstil konfeksion dhe lëkurë, këpucë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes për mënyrat e kontrollit të lëndës së parë;
2. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të standardeve të cilësisë dhe certifikimit e materialeve tekstile, lëkurë dhe gëzof;
3. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së metodave për testimin e cilësisë së materialeve tekstile, lëkurë dhe gëzof;
4. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së makinerive dhe proceseve teknologjike të filaturimit;
5. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së makinerive dhe proceseve teknologjike të prodhimit të pëlhurave të endura, të thurura dhe jo të endura dhe jo të thurura;
6. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së makinerive dhe proceseve përfundimtare të prodhimit të tekstileve, lëkurëve dhe gëzofëve;
7. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së makinerive dhe proceseve teknologjike të përpunimit/prodhimit të lëkurëve dhe gëzofëve;
8. Të argumentojë treguesit e performancës në prodhim;
9. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrën e analizimit të konsumit me efikasitet të lëndës së parë;
10. Të interpretojë defektet dhe shkaqet e tyre, gjatë prodhimit të tekstilit, lëkurëve dhe gëzofëve;
11. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së krijimit të shablloneve;
12. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të zhvillimit të shablloneve;
13. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të testimit dhe përshtatjes së prototipit;
14. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së ekonomizimit të lëndës së parë dhe ndihmëse;
15. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së proceseve të prerjes;
16. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së ecurisë së ndarjes dhe grupimit të elementëve të produktit;
17. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së realizimit të proceseve ndihmëse;
18. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të qepjes;
19. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të shtrimit të lëndës së parë dhe ndihmëse;
20. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të montimit me qepje;
21. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të montimit me ngjitje;

22. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së realizimit të proceseve zbukuruese (dekorative);
23. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së realizimit të proceseve përfundimtare;
24. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së marrjes së masave për eliminimin e defekteve;
25. Të analizojë mënyrat e identifikimit të vonesave në prodhim dhe faktorët që i shkaktojnë ato;
26. Të analizojë mënyrat e menaxhimit të problemeve me makineritë dhe mirëmbajtjen e tyre;
27. Të argumentojë mënyrat e përmirësimit të proceseve duke optimizuar përdorimin e makinerive dhe burimeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë mbikëqyrjen e procesit të kontrollit të lëndës;
2. Të kryejë mbikëqyrjen e proceseve teknologjike në filaturë;
3. Të kryejë mbikëqyrjen e proceseve teknologjike në tezgjahim;
4. Të kryejë mbikëqyrjen e proceseve teknologjike në trikotim;
5. Të kryejë mbikëqyrjen e proceseve teknologjike të prodhimit të pëlhurave jo të endura dhe jo të thurura;
6. Të kryejë mbikëqyrjen e proceseve teknologjike në përpunimin e lëkurëve dhe gëzofëve;
7. Të kryejë mbikëqyrjen e optimizimit të proceseve të prerjes së tekstilëve, lëkurëve dhe gëzofëve;
8. Të kryejë mbikëqyrjen e organizimit të ndarjes dhe grupimit të elementeve përbërës të produktit;
9. Të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të proceseve ndihmëse për prodhimin e produkteve;
10. Të kryejë mbikëqyrjen e procesit të qepjes/montimit me ngjitje për të siguruar qëndrueshmëri dhe cilësi;
11. Të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të proceseve zbukuruese dhe përfundimtare;
12. Të kryejë analizën dhe vlerësimin e treguesit të performancës në prodhim;
13. Të marrë masat për të eliminuar defektet e mundshme, vonesave në prodhim, duke përcaktuar faktorët që i shkaktojnë.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr procesin e kontrollit të lëndës së parë sipas metodikës;
- Mbikëqyr zbatimin e standardeve të cilësisë dhe procedurat e certifikimit për materialet tekstile dhe lëkurët;
- Mbikëqyr testimin e cilësisë sipas metodikës;
- Mbikëqyr funksionimin e makinerive dhe proceseve teknologjike në filaturë, sipas skemës teknike;

- Mbikëqyr funksionimin e makinerive dhe proceseve teknologjike të tezgjahimit sipas skemës teknike;
- Mbikëqyr funksionimin e makinerive dhe proceseve teknologjike të trikotimit sipas skemës teknike;
- Mbikëqyr funksionimin e makinerive dhe proceseve teknologjike të pëlhurave jo të endura dhe jo të thurura , sipas skemës teknike;
- Mbikëqyr funksionimin e makinerive dhe proceseve teknologjike të përpunimit të lëkurës, sipas skemës teknike;
- Kryen saktë analizën dhe vlerësimin e treguesit të performancës në prodhim;
- Mbikëqyr përdorimin me efikasitet të konsumit të lëndës së parë;
- Mbikëqyr identifikimin dhe interpretimin e defekteve gjatë procesit të prodhimit duke analizuar shkaqet e tyre;
- Mbikëqyr krijimin e shablloneve në përputhje me kërkesat teknike;
- Mbikëqyr zhvillimin e shablloneve sipas specifikimeve;
- Mbikëqyr procesin e testimit dhe përshtatjes së prototipit, sipas skemës teknike;
- Mbikëqyr saktësinë e procesit të shtrimit të lëndës së parë dhe ndihmëse, duke e ekonomizuar atë;
- Mbikëqyr procesin e prerjes sipas procedurës;
- Mbikëqyr organizimin e ndarjes dhe grupimit të elementeve të produktit, sipas skedës teknike;
- Mbikëqyr realizimin e proceseve ndihmëse për të garantuar rrjedhshmërinë e prodhimit, sipas procedurës;
- Mbikëqyr procesin e qepjes sipas specifikimeve teknike;
- Mbikëqyr procesin e montimit me qepje për të siguruar qëndrueshmëri dhe cilësi, sipas skedës teknike;
- Mbikëqyr procesin e montimit me ngjitje për të siguruar qëndrueshmëri dhe cilësi, sipas skedës teknike;
- Mbikëqyr realizimin e proceseve zbukuruese sipas dizajnit dhe kërkesave funksionale;
- Mbikëqyr realizimin e proceseve përfundimtare përpara dorëzimit, sipas skedës teknike/prototipit;
- Merr masa për të eliminuar defektet e mundshme sipas procedurës;
- Analizon vonesat në prodhim duke përcaktuar faktorët që i shkaktojnë ato;
- Menaxhon mirëmbajtjen dhe zgjidhjen e defekteve të makinerive sipas procedurës;
- Propozon dhe zbaton mënyra për përmirësimin e proceseve duke optimizuar përdorimin e makinerive dhe burimeve.

NjN-04-IV-0240-25 Kontrolli i cilësisë së produktit përfundimtar në tekstil - konfeksion

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të analizojë cilësinë e fillit të prodhuar;
2. Të analizojë cilësinë e pëlhurave;
3. Të analizojë cilësinë e produkteve të konfeksionuara;
4. Të analizojë cilësinë e produkteve të galanterisë/këpucëve;
5. Të analizojë cilësinë e etiketimit;
6. Të analizojë cilësinë e paketimit;
7. Të analizojë cilësinë e ambalazhimit të produktit përfundimtar.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin e cilësisë së fillit, të tekstilit të prodhuar, të produktit të konfeksionuar dhe produktit të galanterisë/këpucëve;
2. Të kryejë kontrollin e cilësisë së etiketimit, paketimit dhe ambalazhimit të produktit përfundimtar.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së fillit të prodhuar sipas standardit;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së tekstileve të prodhuar sipas standardit;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së produkteve të konfeksionuara sipas prototipit/kampionit;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së produkteve të galanterisë/këpucëve sipas prototipit/kampionit;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së etiketimit të produkteve përfundimtare sipas skedës teknike ose prototipit/kampionit;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së paketimit sipas porosisë;
- Mbikëqyr kontrollin e cilësisë së ambalazhimit të produktit përfundimtar sipas specifikimeve.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionit në fuqi;
2. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së hartimit dhe arkivimit të dokumentacionit financiar;
3. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së llogaritjeve të materialeve;
4. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes të grafikut të kohës së punës;
5. Të analizojë rëndësinë e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe mënyra e përgatitjes së një oferte për produktet/shërbimet;
6. Të analizojë raportet periodike dhe financiare;
7. Të analizojë rëndësinë e marrjes së informacionit nga tregu lidhur me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;

8. Të analizojë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe shërbimeve të kryera;
9. Të analizojë tregun për blerjen e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme;
10. Të analizojë rëndësinë e llogaritjes së çmimit përfundimtar për produktet/shërbimet e ofruara;
11. Të argumentojë rëndësinë e dokumenteve për dorëzimin e produkteve/shërbimeve;
12. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së inventarizimit;
13. Të argumentojë mënyrat e motivimit të stafit;
14. Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të stafit;
15. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të teknikave të marketingut;
16. Të analizojë vetveten;
17. Të analizojë rëndësinë e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
18. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të teknologjive bashkëkohore në proceset e punës;
19. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit dhe transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe teknikave të reja në punë;
20. Të analizojë rëndësinë e ndjekjes së trajnimeve, kurseve teknike, panairove dhe ekspozitave.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e parimeve bazë të kodit të punës dhe legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e një biznesi;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e parimeve e teknikave të marketingut;
3. Të zbatojë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
4. Të përgatisë ofertë për produktin/shërbimin që do të realizojë duke iu referuar çmimeve të tregut dhe cilësisë së mjeteve, pajisjeve dhe materialeve.

Kriteret e vlerësimit

1. Zbaton parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionit në fuqi;
2. Mbikëqyr hartimin dhe arkivimin e dokumentacionit financiar, sipas formatit;
3. Mbikëqyr kryerjen saktë të llogaritjes së materialeve;
4. Mbikëqyr regjistrimin e të dhënave për faturat dhe mënyrën e përgatitjes së një oferte për produktet/shërbimet, sipas procedurës;
5. Mbikëqyr hartimin e raporteve periodike dhe financiare, sipas formateve;
6. Mbikëqyr përditësimin e informacionit nga tregu lidhur me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
7. Mbikëqyr llogaritjen saktë të kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe shërbimeve të kryera;
8. Kryen studimin e tregut për blerjen e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme, në mënyrë periodike;

9. Mbikëqyr llogaritjen e saktë të çmimit përfundimtar për produktet/shërbimet e ofruara;
10. Mbikëqyr plotësimin e dokumentacionit për dorëzimin e produkteve/shërbimeve, sipas formatit;
11. Mbikëqyr kryerjen e inventarit sipas formatit;
12. Motivon dhe vlerëson stafin, vazhdimisht;
13. Mbikëqyr zbatimin e teknikave të marketingut;
14. Përzgjedh metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
15. Zbaton teknologjitë bashkëkohore në proceset e punës;
16. Përditëson dhe transmeton në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe teknikat e reja në punë;
17. Ndjek trajnime, kurse teknike, panairë dhe ekspozita.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të analizojë metodat e informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimi etik dhe profesional;
3. Të shpjegojë rëndësinë e parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rëndësinë e mendimit kritik;
5. Të analizojë rëndësinë e mënyrave të zgjidhjes së konflikteve dhe situatave të ndjeshme (klient/staf);
6. Të analizojë rëndësinë e ndërveprimit me bashkëpunëtorët në veprimtaritë profesionale;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët;
8. Të analizojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
9. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit dhe ruajtjes së konfidencialitetit të klientit/produktit;
10. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e metodave të komunikimit verbal dhe joverbal duke përdorur TIK dhe terminologji profesionale;
2. Të komunikojë saktë dhe në mënyrë profesionale me klientët, bashkëpunëtorët, etj.;
3. Të mbikëqyrë respektimin e parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

Kriteret e vlerësimit

- Informohet periodikisht mbi problemet dhe të rejat e ditës;

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Mbikëqyr zbatimin e parimet e punës në grup;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të komunikimit me eprorët/stafin dhe klientët;
- Merr dhe jep udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë;
- Mbikëqyr zbatimin e teknologjive të reja të komunikimit;
- Mbikëqyr zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjet me eprorët/stafin dhe klientët;
- Menaxhon ruajtjen e konfidencialitetit të klientit/produktit, sipas parimeve të etikës;
- Mbikëqyr përdorimin e terminologjisë profesionale;
- Vepron/Komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera.

NjN-04-IV-0241-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në tekstil – konfeksion

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të standardeve dhe legjislacionit në fuqi për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
2. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të shpjegojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti dhe mjetet përkatëse;
4. Të analizojë rëndësinë e mbikëqyrjes së respektimit të sinjalistikave në mjedisin e punës;
5. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
6. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të kutisë së MZSH3;
7. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së masave përkatëse gjatë përdorimit të solucionave me përmbajtje kimike;
8. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së masave në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
9. Të analizojë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
10. Të analizojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të procedurave të ndarjes së mbetjeve sipas llojit;
11. Të analizojë rëndësinë e mbikëqyrjes së depozitimit të mbetjeve;
12. Të analizojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
13. Të analizojë rëndësinë e ndjekjes së protokolleve të duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

³Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e mbrojtjes së mjedisit dhe higjienës;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e protokolleve për raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin e standardeve dhe legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Mbikëqyr përdorimin e manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas udhëzimeve teknike;
- Zbaton procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe përdor mjetet përkatëse në rast aksidenti;
- Mbikëqyr respektimin e sinjalistikës në mjedisin e punës;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjente në mënyrë të saktë dhe të organizuar;
- Përdor saktë pajisjet dhe materialet e kutisë së MZSH (Ndihma e Parë);
- Mbikëqyr zbatimin e masave mbrojtëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- Merr masa të përshtatshme në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Analizon karakteristikat e një mjedisi të qëndrueshëm;
- Aplikon parimet e ruajtjes së një mjedisi të qëndrueshëm;
- Mbikëqyr ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe kontrollon respektimin e procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që paraqesin rrezik për ndotjen e mjedisit;
- Zbaton protokollet për raste të gjendjes së jashtëzakonshme në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Krijimi i koleksionit (të veshjeve, këpucëve dhe aksesoreve)	25	NjN-04-IV-0237-25
2	Analizimi, planifikimi dhe organizimi i punës në tekstil konfeksion	20	NjN-04-IV-0238-25

3	Mbikëqyrje në tekstil konfeksion dhe lëkurë këpucë	20	NjN-04-IV-0239-25
4	Kontrolli i cilësisë së produktit përfundimtar	20	NjN-04-IV-0240-25
5	Sipërmarrje dhe edukim karriere	6	NjN-23-IV-0005-24
6	Komunikimi etik dhe profesional	6	NjN-22-IV-0006-24
7	Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit në tekstil - konfeksion	3	NjN-04-IV-0241-25
	Totali	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **D-IV-25**

D – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

IV – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-04-IV-0237-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

04 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

IV – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK -së

0237 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit